



Nr. 123 Prot.

Tiranë, më 16 / 03 / 2023



Nr. 102 Prot.

Tiranë, më 16 / 03 / 2023

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### Për Zhvillimin e “Shkencës së Hapur” në Shqipëri

Rekomandimi mbi Shkencën e Hapur është miratuar unanimisht nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në sesionin e saj të 41-të në Nëntor 2021. Për të adresuar problemet me të cilat po përballlet sot bota, ekziston një nevojë urgjente për qasje të barabartë në informacionin shkencor dhe për ndarjen e njohurive shkencore, të dhënave dhe protokolleve brenda dhe jashtë komunitetit të kërkueseve shkencor. Rekomandimi për përfaqimin dhe aplikimin e shkencës së hapur, fuqizon potencialin transformues të shkencës për reduktimin e pabarazive ekzistuese në shkencë, teknologji dhe inovacion. Miratimi i këtij Rekomandimi nga Shtetet Anëtare të UNESCO-s ka nevojë për një kornizë ligjore kombëtare për shkencën e hapur, dhe shprehjen e një vullneti të përbashkët, të cilin e përfaqëson ky memorandum, për të forcuar bashkëpunimin shkencor kombëtar e ndërkombëtar.

**Institucionet e Arsimit të Lartë, si aktorë kryesorë të përfshirë në aktivitete të kërkimit shkencor, janë të ftuar t’i bashkohen këtij memorandum si hapi i parë i përfaqimit të parimeve udhëzuese të mëposhtme për shkencën e hapur:**

- Promovimi i një kuptimi të përbashkët të shkencës së hapur, përfitimeve, sfidave, si dhe rrugët e ndryshme drejt shkencës së hapur;

- Zhvillimi i një mjedisi politikash të favorshme për shkencën e hapur;
- Investimi në infrastrukturë dhe shërbime që kontribuojnë në shkencën e hapur;
- Investimi në trajnime, arsimim, shkrim-lexim digjital dhe ngritjen e kapaciteteve, për t'u mundësuar studiuesve dhe palëve të tjera të interesuara të marrin pjesë në shkencën e hapur;
- Nxitja e një kulture të shkencës së hapur dhe përafrimi i stimujve për shkencën e hapur;
- Publikimin e të dhënave të hapura;
- Promovimi i qasjeve novatore për aplikimin e shkencës së hapur në faza të ndryshme të procesit të kërkimit shkencor;
- Promovimin e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, dypalësh e shumëpalësh në kontekstin e shkencës së hapur me synimin për të reduktuar hendekun e njohurive digjitale dhe teknologjike.

#### Akademia e Studimeve Albanologjike

Rektori

Prof. dr. Luan PËRZHITA



#### Rrjeti Akademik Shqiptar

Drejtori

Dr. Arjan XHELAI

